# BASHKËPUNIMI ME KOMUNITETIN DHE VIKTIMAT E TRAFIKUT, BAZË E STRATEGJISË ANTITRAFIK

**Nga Xhavit Shala**

Intervistë për gazetën ”Korrieri” [1]

**Gazeta ”Korrieri”:** Zoti Xhavit, Drejtoria e Policisë së Fierit pati sukses të dukshëm në strategjinë e luftës antikanabis.Të njëjtat rezultate po vihen re edhe me angazhimin tuaj në luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore, kryesisht në luftën kundër trafikut dhe shfrytëzimit të vajzave me qëllim prostitucioni. Ku qëndron sekreti i suksesit?

**Xhavit Shala:** Suksesi duket ka ardhur pasi ne kemi arritur të krijojmë një ide të saktë se si të punojmë. Patëm sukses me luftën antikanabis pasi angazhuam të gjitha strukturat në Fier, qoftë Drejtësinë, qoftë pushtetin lokal. Njëkohësisht ndamë dhe përgjegjësitë dhe e ndoqëm funksionimin e gjithë “ngrehinës” që krijuam deri në momentin e fundit. Kështu që edhe strukturat e pushtetit lokal edhe policët e zonave mbajtën përgjegjësi, qoftë edhe për një rrënjë canabis të zbuluar në zonat, që ata kishin marrë përsipër.

**Gazeta ”Korrieri”:** Për dy muaj Policia e Fierit ka kapur aq tutorë, përpunuar vajza të mashtruara e të shfrytëzuara, sa nuk ka bërë e gjithë policia e vendit. Si u bë i mundur një rezultat i tillë ?

**Xhavit Shala:** Si në rastin e cannabis-it, gjithçka e filluam me përpunimin e nje strategjie. Në momentin që ajo ishte gati, ftuam dhe na nderoi me pjesëmarrjen e tij edhe Ministri i Rendit Ilir Gjoni, prania e të cilit motivoi strukturat e policisë. Ishte data 11 shtator, kur paraqitëm për herë të parë mënyrat e reja të luftës kundër trafikut të qenieve njerëzore, kryesisht të vajzave të detyruara për të ushtruar prostitucion. Që nga ajo ditë policia ka goditur 14 grupe të ndryshme të trafikut me 35 autorë të cilët akuzohen për vepren penale të trafikut apo shfrytëzimit të vajzave me qëllim prostitucionin. Për më pak se dy muaj, janë dërguar në shtëpitë e tyre 14 vajza viktima dhe është marrë masa e arrestit me burg për 20 tutorë.

**Gazeta ”Korrieri”:** Si është bërë i mundur një rezultat i tillë ?

**Xhavit Shala:** Gjithçka me punë të organizuar. Në Fier kam gjetur një staf të shkëlqyer, njerëz punëtorë, pa shumë pretendime, për të cilët kam respekt. Ndërsa puna është organizuar dhe funksionon e përditshme sipas disa rregullave te caktuara. Si fillim krijuam grupe pune, të cilët shkuan shtëpi më

[1] Intervista është botuar ne Gazeten Korrieri date 31.10.2001

shtëpi për të biseduar me prindërit e të afërmit e vajzave të grabitura ose jo, që ndodhen jashtë vendit dhe që dyshohet se detyrohen të ushtrojnë prostitucion. Këto grupe janë instruktuar të bënin të pamundurën për të mbledhur informacion maksimal. Aty janë përfshirë të gjitha të dhënat për tutorin e vërtetuar apo të dyshuar, që nga paraqitja e parë në shtëpi, deri në adresën e tij ekzistuese apo të përafërt jashtë vendit. Me këto të dhëna organizohej puna për goditjen e trafikantëve dhe bashkëpunohej me Interpol Tiranën dhe Interforcën italiane.

**Gazeta ”Korrieri”:** Ju keni arritur që në më pak se dy muaj te godisni 14 grupe. Si është bërë e mundur ?

**Xhavit Shala:** Sekreti i gjithë suksesit ka qenë bashkëpunimi me vajzat e kthyera në pikat doganore kryesisht me Italinë (portet) dhe në aeroportin e Rinasit. Të gjitha këtyre pikave u kam dërguar urdhër me shkrim, që të ndalojnë përkohësisht të gjitha vajzat me banim në Qarkun e Fierit të kthyera kryesisht nga policia italiane, apo edhe nga vende vende të tjera të Evropës Perëndimore. Menjëherë pas sinjalizimit se ka mbërritur qoftë edhe një vajzë e vetme nga Fieri, dërgojmë një makinë të Komisariatit për ta marrë për intervistim. Kam krijuar një grup të veçantë specialistësh, që merren ekskluzivisht me këtë punë dhe janë duke u kthyer në specialistë të vërtetë, që nuk kanë nevojë t'u rrish mbi kokë. Ata e intervistojnë, i sigurojnë mbrojtje dhe strehim, i bindin të denoncojnë tutorët e tyre. Më pas, në bashkëpunim me Prokurorinë bëhet sigurimi i dëshmive në Gjykatë. Të them të drejtën, sikur kjo e fundit të na ndihmonte që cikli të mbyllej brenda 3 ditësh, kapaciteti përpunues, do të ishte më i madh. Vetëm pas kësaj vajzat, nëse kërkojnë, kthehen pranë familjeve të tyre. Njëkohësisht fillon dhe goditja e tutorëve. Gjithashtu, në Fier kanë funksionuar kontrollet e rrugëve me postblloqe, qoftë fikse, qoftë të lëvizshme, të cilat edhe ato kanë dhënë rezultatet e tyre. Në rrjetën e tyre shpesh kanë rënë tutorë dhe viktima që udhëtonin drejt Vlorës për t'u trafikuar.

**Gazeta ”Korrieri”:** Këtu përfundon gjithçka ?

**Xhavit Shala:** Jo. Puna vazhdon shumë seriozisht me sensibilizimin e opinionit me qëllim që kjo kategori vajzash të mos përbuzet nga shoqëria dhe të kthehet sërish aty ku ishte , pasi puna do të na shkonte dëm. Për këtë qëllim janë bërë takime në të gjitha komunat e fshatrat, së bashku me drejtues te pushtetit lokal e synimin e mësipërm. Na kanë pritur mirë dhe shoh përditë e më tepër se si rritet besimi te shteti dhe veçanërisht te Policia. Në fshatin Ndërmenas, atje ku policia para disa vitesh nuk guxonte te hynte, gjatë një takimi të tillë kam ndjerë një kënaqësi të veçantë. Aty ndjeva se sa dëshirë kishin të gjithë që të realizoheshin ato që po diskutonim. Në vijim të së njëjtës ide struktura të pushtetit lokal dhe disa organizata të huaja në Fier si OSBE apo dhe ICMC, na kanë premtuar të ndihmojnë për punësimin e kësaj kategorie vajzash. Ndërkohë që këta, por edhe subjekte të tjera në Fier janë

duke na ndihmuar për restaurimin e një objekti pritje, për vajzat, për aq kohë sa do të duhet të mbahen brenda ambienteve te Komisariatit.

**Gazeta "Korrieri" 31.10.2001**



INTERVISTA

## Shala: Strategjia antiprostitucion






Ambasadori i OSBE-se  Gert Ahrens, u interesua qe ne fillim dhe mbështeti fuqishëm strategjinë antitrafik ne Fier si dhe Qendrën për Pritjen dhe Mbrojtjen e Viktimave te Trafikut, te ngritur ne ambientet e Drejtorisë se Policisë atje.

Fotot me poshtë paraqesin takimin e Ambasadorit Ahrens me Drejtorin e Policisë Qarkut Xhavit Shala dhe vizitën e tij ne Qendrën e Pritjes dhe Mbrojtjes se Viktimave te Trafikut Fier.





**Gazeta « Zeri Popullit » 28 Tetor 2001**



28 TETOR 2001 — ZERI I POPULLIT 7

ANALIZA

Drejtoria e Policisë të Fierit bën analizën, ja rezultatet e luftës antitrafik, kundër trafikut të qenieve njerëzore dhe krimit

# Policia ndalon 30 trafikantë prostitutash

*Ja gjithë ditari i godities policore. Fieri kap trafikantët e qyteteve të tjera*

**Gazeta « Zeri Popullit » 3 Nentor 2001**



3 NENTOR 2001 — ZERI I POPULLIT

TE NDALUARIT

AKSIONI

Policia ndalon 4 kontrabandistë dhe bllokon 4500 kolb me cigare kontrabandë

FIER

# Fier, prangosen 49 trafikantë femrash

Ndalohen trafikantë nga Shkodra, Berati, Tirana, Lezha, Durrësi, Lushnja, Vlora dhe Fieri

**Gazeta « Zeri Popullit » 12.12.2001**

ANTITRAFIKU

2 milionë lekë për ngritjen e Qendrës për Ruajtjen dhe mbrojtjen e viktimave të trafikut të prostitucionit

# Albpetrol dhe Armo donatorë të këtij projekti

FIER - Për herë të parë në Shqipëri, në ambjentet e drejtorisë së policisë së qarkut Fier "Qendra e ruajtjes dhe mbrojtjes së viktimave të trafikut të prostitucionit". Plot 20 ditë më parë, në ambjentet e komisariatit të policisë u hapën dyert e kësaj qendre ku viktimat e trafikut nuk do t'i duheshin të e ndeshin hapsirave të këtij institucioni, apo të flinin makinave të bllokuara po në këtë komisariat. Ka qenë ideja e kolonel Xhavit Shalës për të institucionalizuar qendrimin e prostitutave deri në momentin e akomodimit të tyre pranë familjeve dhe për ta bërë më të lehtë kallëzimin e tutorëve dhe më tej mbrojtjen e tyre fizike. Sipas të dhënave të kolonel Shalës kjo qendër krijon kushtet që këto femra që kapen gjatë rrugës për jashtë shtetit ose që janë kthyer prej andej të mos vuajnë nga komlexet e frikës për të denoncuar tutorët e tyre. kjo merr një rëndësi të veçantë sidomos në kushtet kur në vendin tonë mungon një ligj i posaçëm që mbron deshmitarët.

Fakti që shume prej prostitutave bënin lëvizje të pakontrolluara në të gjithë komisariatin e policisë, ose qëndronin në ambjente të papërshtatshme e ka detyruar Shalën që një pjese të komisariatit ta rrethojë dhe të mendojë për akomodimin e tyre për sa dite ato do te duhej te qëndrojnë këtu. Në mungesë të fondeve Shala ka vendosur të bashkëpunojë me komunitetin dhe me dy kompanite e fuqishme të industrisë së naftës: Albpetrol dhe Armo ku ka siguruar donacionin e nevojshëm prej 2 milion lekë të reja, për ngritjen e kësaj qendre, e cila përbëhet nga tre kabina të çmontueshme. Një prej tyre është për fjetje me një kapacitet prej 10 vende, tjetra sallë për kalimin e kohës së lire ku nuk mungon edhe televizori, dhe ku mendohet të realizohet edhe komunikimi i tyre me psikolog apo vizita mjeksore. Ndërsa kabina tjetër shërben si banjo me kushte normale. E gjithë kjo qendër është e rrethuar ku nuk mungojnë edhe stolat në ambjentet e jashtme. Kjo qëndër, informon Shala, do të administrohet nga dy OJQ lokale të gravet,t e cilat kanë caktuar një kujdestare, e cila ka në varësi një nënoficinë të policisë. Pjesë e personelit është menduar të jetë edhe një mjek apo psikolog, të cilet do të asistojnë në seanca të veçanta. Vajzat do të rrinë këtu për aq kohë sa të bëhet sigurimi i dëshmisë së tyre dhe më tej sto do te jene të lira të shkojnë pranë familjeve, ndërsa të huajt deri në pritje të sigurimit te riatdhesimit. Që nga fillimi i këtij viti, numri i tutorëve të penalizuar shkon deri në 100 nga të cilat 50 janë kapur dhe kanë përfunduar para organit të drejtësisë, ndërsa gjysma tjetër është nën ndjekjen e forcave të policisë. Ndërsa numri i viktimave të këtij trafiku për këtë periudhe kohe shkon deri në 57. Kolonel Xhavit Shala, informon se ky sukses është i mbështetur në një punë të vazhdueshme të policisë i organizuar në të gjitha pikat kryesore rrugore, akset rrugore përgjatë të gjithe harkut kohor të ditës.

Adriana Hyso

Zeri Popullit 12.12.2001

**Gazeta "Zeri Popullit" 23 Dhjetor 2001**

POLICIA DHE REZULTATET

Analiza vjetore e policive të Vlorës, Fierit, Gjirokastrës

# ANTIKRIMI

ANTITRAFIKU





# Policia e Fierit e suksesshme në luftën kundër trafiqeve

2001, trafiku i qënieve njerëzore, janë proceduar penalisht 100 autore nga të cilët të arrestuar 50

LUFTA KUNDËR DROGËS

LUFTA KUNDËR KRIMIT EKONOMIK

Adriana Hyso

REZULTATET

Analizë e punës një vjeçare Drejtoria e Policisë së Qarkut të Vlorës

## Vlorë, 420 vepra penale, nga të cilat janë zbuluar 342 ose 85 % e tyre

## Flaka përpin "Millenium"-in e Korçës

**Koha Jonë 3.4.2002**

### Fier/Arrestohen edhe tre tutorë

## Trafiku i vajzave, pranga policit spiun

**FIER** - Kallëzimi i një vajze 23-vjeçare çon në birucë një grup trafikantësh prostitucioni nga Lushnja. Ata tentuan ta rekrutonin për ta shfrytëzuar më pas si prostitutë në Itali. Por falë guximit të saj dhe ndërhyrjes në kohë të policisë lokale, vajza shpëtoi. Në një konferencë shtypi, drejtori i policisë së Fierit, Xhavit Shala, tha, dje, se policia kreu një punë profesionale, me mbështetjen e prokurorit të rrethit, i cili u qëndroi në kokë hetimeve, duke prangosur tre nga anëtarët e rrjetit të trafikut, Zharin Kërçuku 26 vjeç, Luan Shehu 51 vjeç dhe Kastriot Lipe, 32 vjeç, u arrestuan në shtëpinë e tyre në Lushnjë, ndërkohë që policia po kërkon 2 bashkëpunëtorë të tyre. Kërçuku ishte paraqitur si burri i ardhshëm i 23-vjeçares nga një fshat i Lushnjës. Ai e kishte njohur me bashkëpunëtorët e tij, të cilët u përpoqën ta bindnin. Por vajza e kuptoi lojën e mashtrimit dhe ia tregoi "skenarin" babait të saj.

Ndërkohë dje pasdite është arrestuar Ervin Sarkaro, oficer i zyrës antitrafik të qendres njerëzore për nxjerrje të sekretit shtetëror. Kur dëgjoi rrëfimin, i ati i vendosur mori të bijën dhe u paraqit me të në zyrën e një oficeri të policisë gjyqësore, ku vajza nënshkroi përmbajtjen e kallëzimit të saj. Në një episod tjetër, të hënën, ndoshta si kurrë më parë, një tutor në Patos u arrit të arrestohej edhe pas kishin kaluar dhjetë vjet qëkur rrëmbeu dhe përdori si prostitutë një 13-vjeçare.

G.Ruko

**Gazeta « Koha Jone », 15 Prill 2002**



8 Koha Jone

# Kronika

Trafiku

Vetëm në tre muaj janë konstatuar 26 raste dhe implikuar 54 autorë. Nga këto, 24 të trafikut të femrave, një i fëmijëve dhe një i klandestinëve

## Fier, atje ku nis goditja e rrjeteve kriminale

**Revista "Klan" 20 janar 2002**



Aktualitet

Reportazh: Dëshmitë e prostitutave të "penduara"

## Një strehë shpresë